



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË
Kosovska Agencija za Forenziku | Kosovo Agency on Forensic



RAPORTI VJETOR

2024



Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	3
Fjala Hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv.....	4
1. Përmbledhja ekzekutive.....	6
2. Divizioni për Cilësi.....	14
3. Departamenti për Traseologji Forenzike.....	17
3.1. Divizioni për Administrimin e provave.	19
3.2. Divizioni për Dokumente dhe Dorëshkrime	21
3.3. Divizioni i Balistikës	22
3.4. Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë	25
4. Departamenti për Kimi dhe Biologji Forenzike.....	27
4.1. Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së,.....	31
4.2. Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve.....	35
4.3. Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit.....	37
5. Departamenti për Teknologji Informative Forenzike	40
5.1. Divizioni për Ekzaminim të Kompjuterëve	40
5.2. Divizioni për Ekzaminim të Imazheve Digjitale, Videos dhe Audio.....	45
6. Divizioni për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	54
7. Përkufizimi i termave dhe lista e shkurtesave.....	55

Hyrje

Agjencia e Kosovës për Forenzikë është institucion i zbatimit të ligjit, që ka për detyrë ofrimin e shërbimeve forenzike për gjykata, prokurori, polici dhe institucione tjera të zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Është e themeluar me ligj si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka organizimin e saj të brendshëm në nivel të departamenteve dhe divizioneve, ku secila njësi ka detyrat e veta të përcaktuara sipas llojit dhe fushës së ekspertizave forenzike që kryen.

Për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Agjencia e Kosovës për Forenzikë, administron edhe me disa sisteme elektronike-baza të të dhënave për tërë Kosovën, dhe në këtë mënyrë vazhdon të funksionoj me sukses duke kontribuar në ndriçimin e shume veprave penale, në ofrimin e paanshëm të analizave objektive shkencore si dhe në përmbushjen e detyrimeve të saja ligjore.

Suksesi profesional i AKF-së është i lidhur ngushtë me saktësinë, precizitetin, sigurinë, vendosmërinë dhe afatin kohor të ekspertizave shkencore. Nisur nga kjo, AKF-ja me gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm i është përgjigjur kërkesave të gjykatave, prokurorive dhe agjencive të zbatimit të ligjit me të vetmin qëllim që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë objektive.

Në funksion të zhvillimit dhe avancimit të mëtejshëm dhe të gjithmbarshëm Agjencia e Kosovës për Forenzikë, mbështet punonjësit e saj-ekspertet e Forenzikës përmes planeve, projekteve dhe trajnimeve të ndryshme qoftë në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtar.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë gjatë vitit 2024, është ri-akredituar në përputhje me standardet ndërkombëtare SK EN ISO/IEC 17025, duke siguruar kritere të kualitetit të lartë në kryerjen e ekspertizave.

Më anë të këtij raporti vjetor të vitit 2024 do të përmbledhim gjithë dinamizmin e veprimtarive dhe aktivitetet e ndryshme duke u kufizuar vetëm në pikat kyçe.

Fjala Hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv

Të nderuar lexues,

Ashtu sikurse edhe vitet paraprake, edhe viti 2024, për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë mund të konsiderohet vit i suksesshëm në kuptim të përmbushjes së misionit, detyrave dhe përgjegjësiqe që ka të përcaktuar më ligjet e në fuqi në shërbim të sistemit të sigurisë dhe drejtësisë në Republikën e Kosovës. Se rezultatet e arritura janë evidente dhe të matshme, dëshmohe me mbi 5400 ekspertiza forenzike të kryera nga fushave të ndryshme që përfshijnë fushën e Balistikës e, Daktiloskopisë, Dokumenteve Dorëshkrimeve/Nënshkrimeve, fushën e ADN-së



M.LL., BA. Ilir KUKAJ

dhe dhe Serologjisë, Narkotikëve, Zjarrëvënjeve Eksploziveve, në fushën e IT Forenzikës, Audios, Videos, Fotografisë etj. Janë kryer me dhjetëra dëshmime dhe mendime në gjykata prokurori, polici institucione të ndryshme, lidhur me raportet e ekspertizave të kryera nga ekspertët, forenzikë të AKF-së, kemi realizuar mbi 10 trajnime profesionale forenzike në fusha të ndryshme poashtu kemi marre pjese ne konferenca ndërkombëtare me të njohura të forenzikes si: AAFS, ENFSI, IAI, etj.,

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional kemi arritur suksese duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi Qendrën me Nacionale Forenzike “ Ivan Vuçetiç ” te Kroacisë, ndërsa ne kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal jemi në pritje të nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit dhe disa vende të rajonit në fushën e forenzikës.

Agjencia e Kosovës për Forenzike gjatë vitit 2024 është ri-akredituar në përputhje më standardet ndërkombëtare SK EN ISO/IEC 17025, duke siguruar kritere të kualitetit të lartë në kryerjen e ekspertizave.

Po ashtu gjatë vitit 2024 kemi pranuar donacion nga UNDP dhe ICMP në pajisje forenzike për Laboratorin e Balistikes dhe Laboratorin e Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve, Laboratorin e ADN-së dhe Serologjisë në vlerë mbi 220.000 euro. Kemi realizuar edhe disa vizita rajonale në Institucionet e forenzike së Shqipërisë dhe Kroacisë.

Kemi rishikuar Strategjinë Zhvillimore të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026, poashtu kemi hartuar Planin e Performances për vitin 2025 i cili është aprovuar nga Ministri i Punëve të Brendshme,

Të gjitha këto aktivitete të realizuar gjatë vitit 2024 do të ndikojnë pozitivisht në rezultate më të larta të punës në institucionin që drejtoj unë.

Duke qenë drejtues i këtij institucioni të rëndësishëm për sistemin e sigurisë dhe drejtësisë në Republikën e Kosovës, jam angazhuar dhe do të angazhohem në përfaqësimin dhe mbrojtjen sa më të mirë, të drejtë dhe suksesshëm të anës së të drejtave të punonjësve dhe në tërësi në të mirë të funksionimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë

Për më në detaje, përmes raportit vjetor të punës për vitin 2024, ju prezantojmë të arriturat kryesore dhe zhvillimet e rëndësishme që kanë ndodhur gjatë këtij viti në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Faleminderit!

M.LL., BA. Ilir KUKAJ

Kryeshef Ekzekutiv.

1. Përmbledhja ekzekutive.

Përmes këtij raporti vjetor 2024, jemi munduar të paraqesim në formë të përmbledhur punët e kryera në shërbimet forenzike, aktivitet e realizuara, planet e realizuara dhe objektivat gjatë vitit 2024 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.

Në këtë raport përveç numrit të rasteve të cilët janë kryer në laboratorët e AKF-së janë përmbushur edhe shumë objektiva të rëndësishme gjatë vitit 2024.


Aktivitetet dhe të arriturat kryesore gjatë këtij viti.

Ky raport përfshinë aktivitetet e zhvilluara dhe të arriturat kryesore të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë gjatë periudhës kohore: 01.01.2024 deri më 31.12.2024. Në këtë raport përveç numrit të rasteve të cilët janë kryer në laboratorët e AKF-së janë përmbushur edhe shumë objektiva të rëndësishme gjatë viti 2020.


Janë kryer me sukses dhe cilësi të lartë 5418 raste - ekspertiza forenzike me mbi 143,067 dëshmi përcjellëse (prova materiale) përcjellëse nga fusha e ADN-së, ekzaminim në IT-forenzike (krime kibernetike), balistikës, dokumenteve, narkotikeve, daktiloskopisë dhe traseologjisë, eksplozivëve dhe zjarrvënjeve.

Po ashtu kemi pasur kërkime në data baza nacionale forenzike si: IBIS (Integrated Ballistic Identification System), AFIS (Automated Fingerprint Identification System) dhe CODIS (Combine DNA Index System) sipas kërkesave të Prokurorive, Gjykatave, Organeve tjera të zbatimit të ligjit dhe Interpolit.

Këto ekspertiza forenzike dhe kërkime (identifikime) në data baza nacionale kanë pasur ndikim të drejtpërdrejt në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, krimeve të rënda dhe vepra tjera të ndryshme penale si dhe në identifikimin e kryerësve të veprave penale.



Grafiku 1. Statistikat e rasteve të pranura (ekspertizave forenzike) gjatë vitit 2024



Grafiku 2. Statistikat e rasteve të përfunduara- (ekspertizave forenzike) gjatë vitit 2024.

<i>Kërkesat për ekspertim</i>	<i>Pranuara</i>	<i>Në Pritje</i>	<i>Në Proces</i>	<i>Ekzaminuara</i>	<i>Dëshmitë</i>
<i>Divizioni i Balistikës</i>	1328	459	168	1261	26693
<i>Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë</i>	704	94	22	678	7290
<i>Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve</i>	1268	56	104	1242	96028
<i>Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së</i>	229	53	93	256	5615
<i>Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikeve</i>	1304	5	164	1375	6386
<i>Divizioni për ekzaminim të Kompjuterëve</i>	454	0	20	474	2039
<i>Divizioni për ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Audios</i>	75	0	0	75	190
<i>Divizioni për analizë të Eksplozivëve dhe Zjarreve</i>	55	75	0	4	242
Total:	5417	742	571	5365	144483

Tabela 1. Statistika e kërkesave për ekspertim në AKF.

Disa nga aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe:

Me rastin e 76 vjetorit të shkencave të forenzikës amerikane në Denver të Kalifornisë- SHBA, të organizuar nga Akademia Amerikane e Shkencave Forenzike, ish Kryeshefi i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë Dr.sc Blerim Olluri i shoqëruar nga një delegacion nga Agjencia e Kosoves për Forenzikë kanë marrë pjesë duke ndjekur nga afër zhvillimet me të fundit të forenzikës amerikane.




Foto 1. Gjate konferencës ne AAFS

Me sukses është përfunduar trajnimi “Emerging Trends in Illicit Synthetic Drug and Production Techniques”. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë dy ekspert nga AKF. Trajnimi është mbajtur në Akademinë Ndërkombëtare për Zbatimit e Ligjit (ILEA) në Budapest, Hungari..

Është realizuar procesi i ri akreditimit për herën e tretë të gjashtë Laboratorëve të akredituara sipas standardit ISO: 17025/2017 si dhe është bërë zgjerimi i akreditimit duke u akredituar për herë të parë edhe Divizioni për ekzaminimin e kompjuterëve nga ekspertet ndërkombëtar nga Turqia përmes Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës /DAK/.

Nga data 20-25 Tetor 2024, dy ekspert të Daktiloskopisë nga AKF, kanë marrë pjesë në konferencën vjetore të FDIAl- Florida Division of International Association for Identification, e mbajtur në Orlando Florida SHBA, e cila ka karakter edukativ dhe trajnues në fushën e identifikimit.

Konferenca Vjetore ka mbledhë së bashku qindra ekspertë të Forenzikës për të paraqitur dhe diskutuar zhvillimet më të fundit në shkencën kriminalistike, me tema të tilla si hetimi i vendit të krimit, gjurmët e gishtërinjve, armët e zjarrit dhe shenjat e veglave, Imazhe fotografike dhe elektronike etj.



Foto 2. Foto e përgjithshme nga FDIAI 2024 në Orlando-SHBA.

Me përkrahjen e UNDP-së nga data 28-30 Gusht 2024 në Hotel Dukagjini, Pejë është mbajtur punëtorja për hartimin dhe finalizimin e Draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

Ekspertet e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i janë nënshtruar 2 testeve të aftësive profesionale të jashtme nga UNODC dhe 11 testeve të jashtme kompania amerikane CTS (Collaborative testing Service) dhe një ushtrim grupor nga ENFSI (European Network for Forensic Science) nga të gjitha fushat e ekspertizës forenzike në AKF, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe krahasimit të rezultateve ekspertet pjesëmarrës me sukses i kanë kaluar të gjitha testet sipas konfirmimit të rezultateve.

Personeli i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë ka realizuar Shtatëdhjetë e pesë (75) prezantime në Gjykatat e Republikës së Kosovë, ku në nivel të eksperteve kanë paraqitur punën e tyre profesionale lidhur me raportet e ekspertizave të ndryshme forenzike.

Personeli i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë gjatë periudhës raportuese ka marrë pjesë në programin e shkëmbimit të përvojave në kuadër të CEPOL-it si dhe në dy punëtori të organizuara njëra nga Ambasada Franceze dhe tjetra nga SEESAC-u.

Personeli i Agjencisë së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë ka realizuar dy vizita studimore , një në Institutin e Forenzikës së Kroacisë “Ivan Vuçetiç” në Zagreb dhe një në Policinë shkencore në Tiranë, Shqipëri.



Foto 3. Foto nga Vizita e eksperteve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë në Institutin e Forenzikës së Kroacisë “ Ivan Vuçetiç” në Zagreb

Janë kryer me sukses revizionimi i të gjitha procedurave dhe formave të punës në të gjitha divizionet e AKF-së për vitin 2024 ashtu siç parashihen me Manualin e Cilësisë në përputhje të akreditimit sipas standardit ISO 17025-2017.

Po ashtu kemi pasur kërkime dhe identifikime të kryerësve të veprave penale në data bazat nacionale forenzike si: AFIS (Automated Fingerprint Identification System) dhe CODIS (Combine DNA Index System) IBIS (Integrated Ballistic Identification System) sipas kërkesave të Prokurorive, Gjykatave, Organeve tjera të zbatimit të ligjit dhe Interpolit.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë me sukses dhe profesionalizëm të lartë është duke e menaxhuar procesimin dhe ekspertimin e të gjitha dëshmive të sjella për ekzaminim të rastit të shpërthimit në Zubin Potok. Janë duke u kryer ekzaminime të shumë dëshmive të këtij rasti në fushën e AND-së/Serologjisë, Balistikës, Daktiloskopisë, Grimcave të barotit dhe FTIS-së.

Është kryer Zhvillimi dhe validimi i procedurave dhe metodave të reja analitike sipas standardit ISO: 17025/2017. Gjatë këtij viti është kryer trajnimi dhe janë validuar metodat për Instrumentin Automate Express, janë krijuar procedurat e reja të Ekstrahimit robotik me Automate Express – dhe janë Validuar dy Kitat e këtij Instrumenti të ADN-së: PrepFiler® Express Forensic DNA Extraction

Kit dhe PrepFiler® Express BTA Forensic DNA Extraction Kit, validimin e tyre e kemi bërë në bashkëpunim me laboratorin e ADN-së të policisë shkencore të Romës, në kuadër të projektit “HAPE”. Me përfundimin e suksesshëm të këtij procesi janë krijuar kushtet për fillimin e Automatizimit të disa fazave të punës në laboratorin e ADN-së.



Foto 4. Foto gjatë validimit të metodave të reja në Divizionin e ADN-së dhe Serologjisë në AKF.

Janë mbajtur mbi dhjetë (10) Trajnime profesionale forenzike si dhe mbi pesëmbëdhjetë pjesëmarrje në aktivitete (konferenca, seminare, grupe punuese, etj).

Me datat 17-20.09.2024 Dy ekspert nga Agjencisë së Kosovës për Forenzikë kanë marrë pjesë në takimin e 30 vjetor të grupit punues të ekspertëve të armëve të zjarrit dhe grimcave të barotit pranë ENFSI (ENFSI FA/GRS EWG) të mbajtur në Vjenë të Austrisë.

Këtë vit kemi rekrutuar pesë punonjës të ri, prej tyre tre teknik për ADN dhe Serologji, një teknik për It forenzikë si dhe një zyrtar për Logjistikë.



Foto 5. Foto e realizuar gjatë trajnimit të eksperteve të drogave nga Instruktorët amerikan.

Nga data 07-11.10.2024, pesë ekspert nga Departamenti për Kimi dhe Biologji kanë vizituar Laboratorin e Forenzikës të Policisë Italiane në Romë. Kjo vizitë studimore është realizuar në kuadër të projektit HAPE për të mbështetur AKF-në gjegjësisht DKBF-në lidhur me trajnimin e avancuar për krijimin e procedurave dhe metodave për pajisjet e pranuar nga BE.

Në Nëntor të këtij viti një ekspert nga Divizioni i Balistikes ka marrë pjesë në takimin e 21-të regional të rrjetit të eksperteve të armëve të zjarrit të Evropës Jug-lindore, lidhur me shkëmbimin e njohurive për trafikimin e armëve dhe procesin e akreditimit të metodave, pjesëmarrës ekspertit nga Balistika i mbajtur në Jahorin, Bosna dhe Hercegovina, e organizuar nga ana e organizatës SEESAC, SEFEN, Nëntor.

Gjatë këtij viti punonjëset e AKF-së kanë marrë pjesë në disa takime të nivelit kombëtar lidhur me sensibilizimin për të drejtat e grave, fuqizimin e rolit të grave në vendimmarrje, takime këto të realizuara në kuadër të fushatave sensibilizuese të organizuara nga Presidentja, ministrja e drejtësisë dhe nivele tjera qeveritare.

2. Divizioni për Cilësi

Divizioni i Cilësisë në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë gjatë vitit 2024 ka zhvilluar dhe zbatuar legjislacionin i cili është në funksion të ruajtjes së integritetit të ekspertizave forenzike. Divizioni i Cilësisë bazuar në legjislacionin në fuqi të AKF-së është përgjegjës për verifikimin dhe sigurimin e cilësisë së ekspertizave, planifikimin dhe menaxhimin e testeve të zotësisë/ushtrimeve grupore për punonjësit shkencor.

Gjithashtu, ka procedurë dhe mekanizëm për kontrollin e cilësisë, sigurimin, funksionimin dhe kalibrimin e aparaturës dhe pajisjeve forenzike, zhvillimin dhe rekomandimin e metodave shkencore të punës, koordinimin, përgatitjen dhe vazhdimin e procesit të akreditimit për Divizionet/Laboratorët e AKF-së.

Divizioni i Cilësisë duke u bazuar në procedurat mbështetëse të AKF-së dhe normave ndërkombëtare ISO/IEC 17025:2017 ka bërë analizën e përgjigjeve dhe opinioneve të palëve të institucioneve për zbatimin e ligjit të Kosovës qofshin ato pozitive apo negative lidhur me shërbimet forenzike që ofron. Opinionet analizohen për të përmirësuar: sistemin menaxhues, veprimet analitike shkencore dhe shërbimet forenzike për klientët (palët).

Divizioni i cilësisë gjatë vitit 2024, përmes mekanizmave të vet ka ngrit efikasitet në sigurinë e cilësisë për ekspertiza forenzike, ka siguruar që të gjitha raportet e ekspertizave forenzike të kenë kriteret e kërkuara sipas standardeve dhe metodologjive bashkëkohore.

Pastaj, Divizioni i Cilësisë gjatë vitit 2024 ka pasur një rol mbikëqyrës në krijimin dhe aranzhimin e testeve profesionale/ushtrimeve grupore nga dy kompani prestigjioze për testet profesionale në fushën e Forenzikës (SHBA dhe Evropë) gjithashtu ka analizuar rezultatet e testeve të aftësive profesionale duke ngritur komisione për vlerësimin e rezultateve dhe rekomanduar komisionet për veprime korrigjuese.

Divizioni për Cilësi në kuadër të AKF-së ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen dhe kontrollin e cilësisë duke zhvilluar dhe zbatuar procedurat e këtij divizioni të cilat janë në funksion të ruajtjes së integritetit të ekspertizave forenzike, duke motivuar personelin shkencor në kërkimin dhe vlefshmërinë e teknikave të reja, procedurave, metodave dhe pajisjeve të përdorura në divizione.

Divizioni i cilësisë ka koordinuar procesin e ri akreditimit, akreditim të metodave shkencore për Laboratorët-Divizionet e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë për vitin 2024,

gjithashtu janë koordinuar veprimet e plotësimit të jo konformiteteve në mes eksperteve ndërkombëtarë dhe atyre të AKF-së me trupën akredituese nacionale - Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK). Gjatë këtij procesi janë Akredituar gjithsejtë 7 (shtatë) Laboratorë/Divizione me gjithsejtë 47 (dyzet e shtatë) metoda shkencore sipas normave ndërkombëtare ISO/IEC 17025:2017.

Në Divizionin e Cilësisë gjatë këtij viti janë realizuar disa aktivitete për sigurimin e cilësisë në divizionet e AKF-së, sipas kërkesave të përgjithshme të Standardit Ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017 si në vijim:

- Planifikimi, sigurimi, administrimi dhe monitorimi i Testeve Profesionale /TP/ nga Collaborative Testing Services, Inc. (CTS) dhe TP nga kompania International Collaborative Exercises (ICE-UNODC), si dhe Ushtrimi Grupor Multidisciplinary Collaborative Exercise 2024 (MdCE 2024) - DNA, Documents, Fingerprints (visualisation and comparison), Fire and Explosions Investigation, Handwriting.
- Divizioni i cilësisë në kuadër të rregullores së cilësisë ka dhe zbaton mekanizmin e kontrollit së cilësisë duke zbatuar rishikimin t administrativ të ekspertimeve para se të lëshohet raporti analitik i ekspertimit nga divizioni përkatës i AKF-së, gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer Rishikimi administrativ i mbi 3001 (tre mijë e një) ekspertimeve /rasteve/ forenzike.
- Divizioni i Cilësisë ka qenë pikë kontakti për bashkëpunim dhe bashkë koordinim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në kuadër të Programit të Shkëmbimit /CEPOL/, më qëllim të ngritjes së kapaciteteve në fushën e trajnimeve dhe aftësive profesionale nga të gjitha aktivitetet që ofron CEPOL.
- Udhëheqje dhe pjesëmarrje në Komisione të niveleve të ndryshme institucionale brenda dhe jashtë Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.
- Koordinimi i zhvillimit të metodave të reja shkencore për akreditim.
- Sigurimi dhe administrimi i ushtrimit grupor multi disiplinuar nga ENFSI.
- Menaxhim dhe koordinimi i masave korrigjuese etj.
- Inspektime në laboratorët/divizionet e AKF-së për aplikimin e masave të sigurisë.

Për vitin 2024, Divizioni i cilësisë nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet në ndonjë konferencë ndërkombëtare-grupe punuese me menaxheret e cilësisë në lidhje me fushëveprimin e Divizioni të Cilësisë për ngritjen dhe zhvillimin e infrastrukturës për sigurimin e cilësisë së ekspertimeve forenzike sipas Standardit Ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017.

Punonjësit e Divizioni i Cilësisë janë menaxher të dy kontratave dhe ka të caktuar Zyrtaren përgjegjëse për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimit të Planit të Integritetit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

- Titulli i kontratës: “Furnizim me teste të aftësive profesionale për stafin e AKF-së”, me numër të: 214-23-8308-1-2-1/C379.
- Titulli i kontratës: “Furnizim me uniforma laboratorike dhe zyrtare për AKF” me numër: 214-24-2741-1-2-1/C430.

Divizioni i Cilësisë ka edhe shumë aktivitete tjera të ndryshme të përfunduara në nivel Divizioni dhe Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.



Foto 6. Certifikata e Akreditimit nga DAK

3. Departamenti për Traseologji Forenzike.

Departamenti i Traseologjisë Forenzike është një nga tre departamentet e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë që ofrojnë shërbime forenzike për institucionet e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Departamentit për Traseologji Forenzike kryhen ekspertiza forenzike, ofrohen shërbime mbështetëse forenzike dhe kërkime në sisteme dhe baza të dhënave.

Departamenti për Traseologji Forenzike përbëhet nga katër divizione:

- Divizioni për Administrimin e provave.
- Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve.
- Divizioni i Balistikës.
- Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë.

<i>Kërkesat për ekspertim</i>	<i>Pranuara</i>	<i>Në Pritje</i>	<i>Në Proces</i>	<i>Ekzaminuar a</i>	<i>Dëshmitë</i>
<i>Divizioni i Balistikës</i>	1328	459	168	1261	26693
<i>Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë</i>	704	94	22	678	7290
<i>Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve</i>	1268	56	104	1242	96028
<i>Total:</i>	3300	609	294	3181	130011

Tabela 2. Statistika - Departamenti për Traseologji Forenzike.

Këta divizione operojnë me sistemin LIMS, IBIS/EVOFINDER, CABIS dhe bazat e të dhënave të dokumenteve, parave, armëve të zjarrit dhe lëndëve për ekspertim.

Ky Departament ka gjithsej 25 punonjës të cilët kanë kualifikimet adekuate, përvojën më shumë se dhjetëvjeçare dhe trajnimet e specializuara për fushat ku punojnë. Ambienti i punës, pajisjet e punës dhe kryerja e shërbimeve forenzike nga punonjësit e këtij departamenti janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kjo falë donacioneve nga organizatat ndërkombëtare, shtetet mike dhe buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, një mbështetje e madhe nga akterët e lartshënuar është dhënë edhe në kryerjen e trajnimeve të specializuara jashtë vendit, pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare forenzike dhe vizitat ndërinstitutionale.

Në kuadër të Departamentit për Traseologji Forenzike kryhen këto shërbime forenzike:

- pranim-dorëzimi i lëndëve për ekspertime forenzike;
- regjistrimi dhe administrimin e lëndëve me sistemin LIMS;
- ekspertimi i armëve të zjarrit, municioneve, gëzhojave dhe predhave;
- përcaktimi i distancën së gjuajtjes me armë zjarri;
- rikonstruimi i rasteve ku ka pasur të shtëna me armë zjarri;
- insertimi dhe kërkimi i imazheve balistike në sistemin IBIS/EVOFINDER;
- ekspertimi i dokumenteve, dorëshkrime, nënshkrimeve dhe parave;
- ekspertimi i gjurmëve të gishtërinjve;
- insertimi dhe kërkimi i kartelave dhe gjurmëve daktiloskopike në sistemin CABIS;
- ekspertimi i gjurmëve të këpucëve, gomave dhe veglave.

Departamenti për Traseologji Forenzike kryhen ekspertiza forenzike në bazë të 23 metoda të akredituar me standardin ISO 17025, që është një nga treguesit e profesionalizimit dhe besueshmërisë së punës së këtij departamenti. Gjatë këtij viti janë pranuar 3300 kërkesa për ekspertime forenzike dhe janë lëshuar 3181 raporte të ekspertimit në kuadër të departamentit.

Objektivat për vitin e ardhshme janë rritja e numrit të pranim-dorëzimit të rasteve, rritja e numrit të ekspertimeve, plotësimi i nevojave për ngritjen profesionale të resurseve humane, furnizimi me pajisje dhe shkëmbimi i përvojave me institucione ndërkombëtarë të fushës së forenzikes.

Për rritjen e numrit të pranim-dorëzimit të rasteve dhe numrit të ekspertimeve Departamenti për Traseologji Forenzike, ka nevoja për shtimin e numrit të punonjësve. Pra, më shumë se gjysma e punonjësve që ofrojnë shërbime forenzike në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë punojnë në kuadër të këtij departamenti, me nder dhe përkushtim, si dhe japin më të mirën e tyre për institucionet e republikës së Kosovës, respektivisht për qytetarë e tyre.

Synim i departamentit është që këtyre punonjësve të ju krijohen mundësit për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtarë të forenzikës, por kjo nuk do jetë e mundur pa mbështetjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Misioni i Departamentit të Forenzikës Krahimore është kryerja e ekspertizave kriminalistike nga fusha balistike, traseologjike, daktiloskopike, financiare, ekzaminimin shkencor të dokumenteve, ekzaminimin grafik të dorëshkrimeve dhe të ngjashme.

Departamenti për Traseologji Forenzike përbëhet nga katër (4) Divizione:

- Divizioni për Administrimin e provave.
- Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve.
- Divizioni i Balistikës.
- Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë.

Gjatë këtij viti në Departamentin për Traseologji Forenzike gjegjësisht në Divizionet (Laboratorët) e tij kanë arritur që ta plotësojnë planin vjetor të punës dhe objektivat për vitin 2019.

Një përmbledhje e shkurtër e detyrave dhe aktiviteteve që janë kryer nga personeli i Divizioneve në fjalë janë të cekura si me poshtë.

3.1. Divizioni për Administrimin e provave.

Divizioni për Administrimin e provave është përgjegjës për pranimin, dorëzimin dhe ruajtjen e dëshmimeve, sistemin, organizimin dhe mirëmbajtjen e arkivës, së AKF-së si dhe njoftimin e palëve për çështjet që kanë të bëjnë me ekspertizën, etj.

Nga ky divizion gjatë vitit 2024 janë administruar pesëmijë e katërqindeshtatëmbëdhjetë (**5417**) kërkesa me gjithësej njëqindekaterdhjetetremije e katerqindekaterdhjet (**143440**) dëshmi për ekspertime forenzike dhe kërkesave për kërkime në databaza nacionale forenzike si: IBIS/EVOFINDER, CAFIS dhe CODIS sipas kërkesave të Prokurorive, Gjykatave, Organeve tjera të zbatimit të ligjit dhe Interpolit.

Punonjësit e këtij divizioni gjatë vitit 2024 kanë arkivuar lëndët e vitit 2022, kanë bërë dorëzim-pranimin e lëndëve kur janë kërkuar nga ekspertët për prezantim në gjykata dhe kanë bërë inventarizimin e dhomës së provave.

Po ashtu zyrtarët e Divizionit për Administrimin e Provave kanë qenë të angazhuar në komisione të ndryshme brenda AKF-së dhe është mbajtur trajnimi për regjistrimin e rasteve në sistemin LIMS për tre punonjës.

<i>Kërkesat për ekspertim</i>	Kërkesa të Pranuara	Regjistruar në LIMS	Në Pritje	Në Proces	Ekzaminuara	Raste të Dorëzuara	Dëshmitë për ekspertim
<i>Divizioni për Administrimin e Provave</i>	5417	4833	/	/	/	15369	143440

Tabela 3. Divizionit për Administrimin e Provave -Statistikat



Foto 7. Zyrtarja e pranimi gjatë procesit të punës me palët e jashtme.

Ndërsa Objektiv i këtij Divizioni për vitin e ardhshëm mbetet pranimi-dorëzimi i rasteve për ekspertim/analizë, futja e rasteve në sistemin “LIMS”, pranim - dorëzimi i rasteve për kërkime në sistemet automatike, arkivimi i dosjeve, inventarizimi i dhomës së provave si dhe ngritja e kërkesave për furnizim.

3.2. Divizioni për Dokumente dhe Dorëshkrime

Bazuar në legjislacionin në fuqi të AKF-së Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve është përgjegjës për Ekspertimin e të gjitha llojeve të dokumenteve vendore dhe ndërkombëtare me nivel të sigurisë së lartë, të mesme dhe asaj të ulët si psh: dokumente të udhëtimit, pasaporta, patentë shofer, letërnjoftime, letra me vlerë, bileta etj, kryerja e ekspertimeve të ngjyrës, stampave (vulave) të thata dhe me ngjyrë; makinave të shkrimit: mekanike dhe elektronike dhe dokumenteve të shtypura me makinë shkrimi, analiza e bojës së lapsit (kimikut) etj.

Aktivitetet e përgjithshme

Divizioni për Dokumente dhe Dorëshkrime gjatë vitit kalendarik 2024 në tërësi e ka përmbushur planin e paraparë të punës duke kryer me sukses të gjitha rastet e pranura gjatë këtij viti. Divizioni/Laboratori për dokumente dhe dorëshkrime përgjatë kësaj ka kryer më sukses procesin Ri akreditimit duke realizuar vlerësimin nga Eksperti ndërkombëtar nën mbikëqyrjen e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës.

Gjatë këtij viti Ekspertet e Divizionit/Laboratorit për dokumente dhe dorëshkrime kanë marr pjesë në mbi 25 seanca të ndryshme Gjyqësore të lëndëve penale dhe civile me ftesën e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Gjithashtu kanë prezantuar edhe në Intervista pranë prokurorive në cilësinë e ekspertit- dëshmitarë.

Angazhime tjera të rëndësishme

Përveç detyrave të përcaktuara me akte nënligjore, personeli ka qenë i angazhuar në grupe punuese duke marrë pjesë në hartimin, ndryshimi, plotësimin dhe revizionimin e akteve nënligjore të AKF-së.

Me kërkesë të Prokurorisë janë kryer ekspertime urgjente në ditët e lira dhe të festave. Me këtë rast ekspertet e divizionit kanë prezantuar në vendin e punës dhe më urgjencë kanë kryer ekspertimet konform legjislacionit në fuqi të AKF-së. Drejtori i Departamentit së bashku me një ekspert nga divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve gjatë muajit Shtator kanë marr pjesë në takimin një (1) ditor organizuar dhe mbajtur nga Banka Qendrore e Kosovës në Prishtinë në lidhje me krijimin e një sistemi efektiv kundër parave të falsifikuara.



Foto 8. Ekspertja e Dokumenteve gjatë procesit të ekspertimit të dokumenteve

Ekspertet e Divizionit/Laboratorit për dokumente dhe dorëshkrime kanë marr pjesë në punëtorinë e vlerësimit të kapaciteteve të institucioneve për luftimin e falsifikimit të parave organizuar nga Banka Qendrore e Kosovës mbështetur nga TAIEK, mbajtur në Nëntor në Prishtinë.

Ekspertet nga Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve kanë marrë pjesë në linçimin e projektit PERICLES IV të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Banka Kombëtare e Kroacisë lidhur me luftimin e falsifikimit të monedhave dhe kartëmonedhave EURO dhe krijimin e Qendrave Kombëtare të Analizës mbajtur në Kroaci.

Akreditimi i metodave

- Është bërë revizionimi vjetor i procedurave standarde të punës për Laboratorin e Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve sipas kërkesave të Divizionit për Cilësi.
- Procedurat e revizionuara kanë kaluar nëpër procedurat e kontrollimit dhe vlerësimit dhe janë aprovuar nga Divizioni i Cilësisë.

3.3. Divizioni i Balistikës

Divizioni i Balistikës është përgjegjës për ekspertimin e armëve të zjarrit, municionit, gëzhgojave, plumbave, shurdhuesve të armëve, mekanizimit për tërheqje të këmbëzës, ekspertimin e numrave të karrocërisë së automjeteve, përcaktimi i trajektorëve të të shtënave, krahasimet mikroskopike, etj.

Aktivitetet e përgjithshme

Divizioni i Balistikës gjatë vitit 2024 në tërësi e ka përmbushur planin e paraparë të punës. Ka kryer me sukses dhe profesionalizem 1217 ekspertiza dhe 20.000 dëshmi.

Poashtu Janë futur imazhet e mbi (4006) rasteve në sistemin për krahasimet balistike Evofinder të gjitha raste kriminale që janë raste të hapura (gëzhoja), që ishin të futura në sistemin IBIS-ë, mirëpo për shkak të vënies në funksion të sistemit të ri Evofinder.

Eksperte e Divizionit të Balistikes janë pergjigjur të gjitha ftesave të gjykatave në cilesi të ekspertit sa herë që ata na janë drejtuar për sçarime apo informata me të detajuara, poashtu kanë marr pjesë në mbi 10 raste të rikonstruimit të vendit të ngjarjes. Vlen të theksohet se Divizioni i Balistikës gjatë vitit 2024 në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara ka realizuar edhe disa projekte më përkrahjen e UNDP-së për zhvillimin dhe profesionalizimin e divizionit.

- Trajnim nga ana e organizatës SEESAC, lidhur me inteligjencën për armë të vogla të lehta dhe municioneve, ku ka ndjekur trajnimin eksperti nga divizioni i Balistikës i mbajtur në Hotelin “SWWIS DIAMOND”, Nëntor, tre (3) ditë.
- Pjesëmarrje në takimin e 21-të e një regjional të rrjetit të eksperteve të armëve të zjarrit të Evropës Jug-lindore, lidhur me shkëmbimin e njohurive për trafikimin e armëve dhe procesin e akreditimit të metodave, pjesëmarrës ekspertit nga Balistika i mbajtur në Jahorin, Bosna dhe Hercegovina, e organizuar nga ana e organizatës SEESAC, SEFEN, Nëntor, dy (2) ditë.
- Pjesëmarrja e ekspertëve nga divizioni i Balistikës në trajnimin për Inspektor për inspektimin e armeve të çaktivizuar mbajtur në Francë, Tetor, pesë (5) ditë.
- Pjesëmarrës ekspertet nga divizioni i Balistikës dhe Gjurmeve të Gishtave në ushtrimin një (1) ditor organizuar nga Drejtoria e Forenzikës në Policinë e Kosovës, rast (simulim) i një sulmi terrorist në një zonë të banuar .Ushtrimi është mbajtur në kampin Vrella, Qershor.

Akreditimi i metodave

Gjatë vitit 2024 është bërë akreditimi i metodave të punës sipas standardit ISO:17025:2018, ku janë akredituar metodat: ekzaminim i armëve të zjarrit, metoda për ekzaminim të municionit, metoda për ekzaminim të gëzhojave, gëzhojat e municionit të gjuetisë dhe komponentët e tyre dhe metoda për plumbat (predhat). Nuk ka qenë e nevojshme që të bëhen revizionim i procedurave për shkak që ato veç janë akredituar vitin që e lamë pas.

Sfidat:

Sfidë është edhe mosrealizimi i kërkesës për furnizimi më municion dhe pajisje për rregullimin e armëve dhe jemi duke operuar më rezerva të municionit të cilat janë trashëguar nga Policia e Kosovës.



Foto 9. Grupi ekspertëve të balistikës gjatë procesit të punës



Foto 10. Foto gjate trajnimit për Çaktivizimin e armeve te zjarrit

3.4. Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë

Divizionit i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë është përgjegjës për kryerjen e ekspertimeve daktiloskopike dhe traseologjike, futjen e të dhënave daktiloskopike në sistemin AFIS në nivel qendrorë (AKF) dhe rajonal (terminalët e AFIS-it në rajonet policore Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjiilan dhe Ferizaj, Aeroporti i Prishtinës, pika kufitare Vërmicë, Hani i Elezit si dhe Glloboqicë poashtu mirëmban të gjitha kartelat dhjetëgishtore origjinale dhe siguron kualitetin e kartelave dhjetëgishtore përmes implementimit të teknikave të instruara të gjurmëve të gishtërinjve me ngjyrë etj.

Aktivitetet e përgjithshme

Gjatë këtij viti Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë ka arritur që të plotësoj planin vjetor të punës dhe objektivat e vitit 2024 duke kryer më sukses dhe profesionalizem mbi 900 ekspertiza dhe 2500 dëshmi percjellëse. Janë bërë kërkime, krahasime apo janë futur në data bazën nacionale forenzike CABIS kartela dhjetëgishtore dhe gjurmë latente.

Harmonizimi i Procedurave Teknike Standarde të Operimit, sipas: ISO 17025.

- Është kryer më sukses testi i aftësive profesionale për Daktiloskopi „Latent Print Examination” nga kompania CTS si dhe testi i aftësive profesionale për Traseologji „Footwear Imprint Evidence”.
- Është bërë Inspektimi nga ekspertet e Daktiloskopisë Divizionit të AKF-së i stacioneve të CABIS 7.0, në Zyrat Rajonale të Policisë së Kosovës, ku është përpiluar raporti i Inspektimit të stacioneve të CABIS.
- Trajnimi i punonjësve të Divizionit të Daktiloskopisë dhe Traseologjisë, nga kompania kontraktuese, mbajtur në objektin e AKF-së, në agjendën e **THALES**, Nëntor, tre (2) ditë, për të Operuar në sistemin CABIS 7.0 „Cogent Automated Biometric.
- Gjatë vitit ekspertet e Divizionit të Daktiloskopisë dhe Traseologjisë kanë marrë pjesë në testet e aftësive nga Collaborative Testing Service (CTS), si dhe në ushtrime grupore nga European Network of Forensic Science Institutes (ENFSI).

- Ekspertet nga divizioni i Gjurmëve të Gishtave kanë marrë pjesë në konferencën vjetor e të FDIAI- Florida Division of International Association for Identification, e mbajtur në Orlando Florida SHBA, Tetorë, pesë (5) ditë.



Foto 11. Ekspertet e Daktiloskopisë gjatë trajnimit në AKF.

4. Departamenti për Kimi dhe Biologji Forenzike

Departamenti për Kimi dhe Biologji Forenzike është njeri nga tri departamentet në nivel të AKF-së, dhe në kuadër të këtij departamenti funksionojnë tri Divizione:

- Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së,
- Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve dhe
- Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit.

Te arriturat kryesore dhe aktivitetet në nivel të departamentit

Pjesëmarrja në takimin vjetor të AAFS-ë.

Nga data 19-24.02.2024, Zv Drejtori i Departamentit së bashku me delegacionin e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, me ftesë dhe në përkrahje të autoriteteve amerikane kanë marrë pjesë në “American Academy of Forensic Sciences, 76st Annual Scientific 2024” të mbajtur në Denver, Colorado - SHBA.



Foto 12. Foto nga AAFS -2024 Denver, Colorado

Udhëheqja dhe koordinimi i trajnimeve të avancuara për funksionalizimin e instrumenteve analitike të pranura projekti IPA dhe të përkrahura nga projekti HAPE.

Në fund të muajit Prill kemi pritë në vizitë z. Giuseppe Codispoti – drejtor i Laboratorit qendror të Policisë Italiane, i angazhuar nga Projekti HAPE për identifikimin e nevojave lidhur me Trajnimet e avancuara për pajisjet analitike (Instrumentet) e pranura si pjesë e projektit IPA.

- Në shator të këtij viti divizionet e DKBF-së i kanë vizituar dy ekspertë nga Laboratori i Policisë Italiane me qëllim të identifikimit dhe koordinimit të procesit të trajnimit të avancuar të planifikuar dhe të mbështetur nga projekti HAPE.
- Nga data 07-11.Tetor 2024, pesë ekspert nga Departamenti për Kimi dhe Biologji kanë vizituar Laboratorin e Forenzikës të Policisë Italiane në Romë. Kjo vizitë studimore është realizuar në kuadër të projektit HAPE për të mbështetur AKF-në gjegjësisht DKBF-në lidhur me trajnimin e avancuar për krijimin e procedurave dhe metodave për pajisjet e pranuar nga BE.

Ri akreditimi dhe zgjerimi i akreditimit

- Me datën 07.05.2024 nga DAK (Drejtoria e Akreditimit e Kosovës), përmes zyrës së cilësisë kemi pranuar Certifikatën e Akreditimit dhe Anexin e saj me të cilin rast është konfirmuar ri-akreditimi apo vazhdimi i akreditimit i 18 metodave analitike në tri divizionet e departamentit dhe zgjerimi i akreditimit për tri metoda të reja analitike, dy nga të cilat në fushën e ADN-së dhe një metodë në fushën e analizës dhe identifikimit të substancave narkotike.

Koordinimi i projektit për krijimin e njësisë për identifikimin e personave të zhdukur përmes analizës së ADN-së, në kuadër të Laboratorit të ADN-së, projekt ky i përkrahur nga BE-ja dhe i implementuar nga ICMP.

Me datën 19 Nëntor 2024 në ambientet e AKF-së është mbajtur takimi me përfaqësues të lartë të ICMP-së. Në këtë takim është diskutuar ecuria e projektit të përbashkët dhe hapat e mëtejshëm drejt realizimit të projektit si dhe mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në të ardhmen.

Mbikëqyrja dhe koordinimi i shpenzimeve dhe buxhetit në nivel të departamentit

Përkujdesja për inicimin e kërkesave dhe projekteve për realizimin e planit të prokurimit dhe krijimin e kushteve të funksionimit normal dhe pa ndërprerje të ekspertimeve forenzike qoftë për shkak të problemeve teknike të instrumenteve analitike, qoftë materialit shpenzues laboratorik (kita, kemikate, reagensë, mostra referente, enëve dhe pajisje laboratorike, etj).

Udhëheqja dhe koordinimi i projektit për implementimin e programit Fulbright për realizimin e trajnimit bazik për krijimin e metodës për analiza kuantitative të narkotikeve.

- Nga data 26.08.2024-06.09.2024 në Divizionin për Analiza Kimike të Narkotikëve është realizuar trajnimi bazik për analiza kuantitative të narkotikeve i cili është udhëhequr nga ekspertja e përzgjedhur, znj. Sue Pearing nga SHBA. Ky trajnim është përkrahur nga programi Fulbright përmes ambasadës së SHBA-ve në Kosovë.



Foto 13. Foto nga trajnimi përkrahur nga programi Fullbright

Pjesëmarrja ne konferencën ndërkombëtare për teknikën kriminalistike - Policia e Kosovës, ne cilësinë e ligjëruesit me temën: Zjarreve mbajtur me 15-16 Tetor 2024 në Prishtinë.

Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe atij ndërkombëtar.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në cilësinë e pikës se kontaktit për Kosovën në EUDA (Eurpoian Drugs Agency) për sistemin e paralajmërimit të hershëm gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar disa aktivitete si në vijim:

- Koordinimi dhe shpërndarja e informatave të pranura nga EUDA lidhur me Substancat e Reja Psikoaktive (NPS) të shpallura si të rrezikshme në bazë të rezolutave të BE dhe që janë të aplikueshme për vendet e BE, me Institucionet dhe mekanizmat kombëtar që ndërlidhen me këtë veprimtari.
- Për këtë periudhë raportuese janë përcjellë njoftimet për 47 Substanca te Reja Psikoaktive (NPS) te shpallura si te rrezikshme sipas Rregullores (EC) No 1920/2006 dhe Vendimit te Këshillit 2004/757/JHA.
- Përveç tjerash, vlen të përmendet edhe bashkëpunimi dhe komunikimi i mirëfilltë praktik dhe profesional me Hetuesit nga Policia e Kosovës dhe Prokurorët dhe Gjyqtarët nga Prokuroritë dhe Gjykatat kompetente të Kosovës ku në kuadër të kësaj i kemi asistuar Policisë së Kosovës ne vend të ngjarjes në raste të ndryshme si ato të laboratorëve klandestine të drogave, të rastet e terrorizmit, etj kur është kërkuar.

- Po ashtu ekspertet ne nivel të departamentit kanë dëshmuar në cilësinë e ekspertit për raste kur janë ftuar nga Gjykata apo Prokuroria kompetente.
- Ky bashkëpunim dhe komunikim ka dhënë rezultate pozitive si në ngritjen e kapaciteteve profesionale në Policinë e Kosovës po ashtu edhe në lehtësimin dhe shkurtimin e procedurave gjyqësore në gjykatat dhe prokuroritë Kompetente të Kosovës.
- Pjesëmarrja ne grupin punues ndërinstitutional për hartimin dhe vlerësimin e Strategjisë nacionale kundër drogave dhe planit të veprimit 2024-2028.
- Me datën 17-20.09.2024 Drejtori i Departamentit për Kimi dhe Biologji Forenzike ka përfaqësuar Divizionin i Eksploziveve, Zjarreve dhe Grimcave te Barotit duke marrë pjesë ne takimin e 30-të vjetor të grupit punues të Armëve të zjarrit/Grimcave të barotit (GSR) në kudër të ENFSI-t që është mbajtur në Vjenë.



Foto 14. Foto nga pjesëmarrja ne takimin e 30-të vjetor të grupit punues (GSR) të ENFSI-t, Vjenë 2024.

Pjesëmarrja ne komisione dhe grupe punuese në kuadër të AKF-së për hartimin e procedurave, rregulloreve dhe dokumenteve strategjike te AKF-së.

Plotësimi i objektivave

Marrë si tërësi në nivel të Departamentit janë përmbushur dhe realizuar objektivat e planifikuara për vitin 2024 duke përfshirë:

- Ekspertimin e rasteve
- Trajnimet dhe pjesëmarrja ne konferenca dhe aktivitetet tjera
- Ri akreditimi dhe zgjerimi i akreditimit

Objektivat për vitin 2025

- Kryerja e ekspertizave Forenzike
- Dëshmimi ne gjykatë dhe prokurori i ekspertëve
- Implementimi dhe realizimi i planit te Prokurimit 2025
- Certifikimi i ekspertëve për kryerjen e ekspertizës Serologjike dhe të ADN-së
- Përfundimi i trajnimit te avancuar i përkrahur nga projekti HAPE dhe validimi i metodave te reja sipas plan programit me projektin HAPE.
- Pjesëmarrja ne grupe punuese te ENFSI-t për Divizionin për ekspertizë të Narkotikëve.
- Kryerja e testeve te aftësive profesionale dhe pjesëmarrja ne trajnime, vizita studimore dhe konferenca shkencore.
- Mbikëqyrja e akreditimit nga ekspertet ndërkombëtar të metodave të akredituara

4.1. Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së,

Divizioni i ADN-së dhe Serologjisë është përgjegjës për kryerjen e analizave forenzike të ADN-së dhe analizave forenzike Serologjike (analizave të lëngjeve të ndryshme trupore, të cilat i paraprijnë analizave të ADN-së). Gjithashtu, Divizioni i ADN-së e mirëmban dhe menaxhon Bazën e të Dhënave të ADN-së – CODIS (futja, ruajtja dhe krahasimi i profileve të ADN-së për qëllime forenzike). Po ashtu, që nga viti 2020 Divizioni i ADN-së, i kryen edhe Testet e Atësisë te cilat bëjnë pjese ne kuadër te rasteve Civile.



Foto 15. Ekspertet e ADN-së në hapësirat e laboratorit të ADN-së.

Realizimi i planit vjetor i punës.

Gjatë këtij viti Divizioni i ADN-së dhe i Serologjisë ka kryer më sukses 248 ekspertiza të ADN-së me mbi 5,600 dëshmi të ndryshme, poashtu janë realizuar një sërë aktivitetesh të rëndësishme. Përveq ekspertizave, ekspertët e ADN-së kanë dëshmuar si dëshmitar ekspert në raste të ndryshme në Gjykatat e vendit.

Me kryerjen e këtyre ekspertizave laboratorit i ADN-së ka kontribuar shumë në ndriqimin e veprave të ndryshme kriminale.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 është kryer Trajnimi dhe janë Validuar Metodatat për Instrumentin Automate Express, janë krijuar procedurat e reja të Ekstrahimit robotik me Automate Express – dhe janë Validuar dy Kitat e këtij Instrumenti të ADN-së: PrepFiler® Express Forensic DNA Extraction Kit dhe PrepFiler® Express BTA Forensic DNA Extraction Kit, validimin e tyre e kemi bërë në bashkëpunim me laboratorin e ADN-së të policisë shkencore të Romës, në kuadër të projektit “HAPE”. Me përfundimin e suksesshëm të këtij procesi janë krijuar kushtet për fillimin e Automatizimit të disa fazave të punës në laboratorin e ADN-së.

Gjithashtu ka vazhduar bashkëpunimi i laboratorit tonë, me laboratorët e ICMP-së, ku nga ky institucion ndërkombëtar jemi në pritje të realizimit të donacionit të radhës (pajisja me disa Frigorifer laboratorik).




Foto 16. Njëri prej instrumenteve të ADN-së, gjatë procesit të punës.

Aktivitete të realizuara

Gjatë këtij viti në laboratorin e ADN-së janë zhvilluar këto aktivitete të rëndësishme:

- Në fillim të vitit pas procesit të rekrutimit, në divizionin e ADN-së është pranuar staf i ri prej 3 teknikëve, dhe ka filluar Trajnimi bazik i tyre rreth Ekspertizave të ADN-së nga mostrat biologjike. Në pjesën e parë të vitit është bërë një punë e madhe sa i përket përfundimit të Ekspertizave të ADN-së të rastit të Banjskes (rasti me numër 2023-3062), për çka i gjithë stafi i cili ka qene i përfshirë në këtë rast.
- Me datën 03.05.2024 me sukses ka përfunduar cikli i Tretë i Akreditimit të Metodave Shkencore.
- Në laboratorin tonë, prej datës 15-17 Gusht kanë qëndruar për një Vizite Studimore Ekspertët nga Shqipëria, vizitë kjo e rëndësishme për shkëmbimin e njohurive në mes të laboratorëve respektiv.
- Prej datës 7-11 Tetor është realizuar Vizita Studimore në laboratorët e Policisë Shkencore në Romë-Itali.
- Prej datës 29-31 Tetor, në kuadër të projektit HAPE, nga një ekspert francez është kryer trajnimi për Mbrojtjes e të Dhënave.
- Prej datës 25 Nëntor-06 Dhjetor, në hapësirat e laboratorit tonë, është kryer Trajnimi dhe Validimi për Metodën e reja të Ekstrahimit Robotik me instrumentin Automate Express. Me këtë rast, janë Validuar dy Kitat e këtij Instrumenti të ADN-së: PrepFiler® Express Forensic

DNA Extraction Kit dhe PrepFiler® Express BTA Forensic DNA Extraction Kit. Këtë proces e kemi kryer në bashkëpunim me ekspertët Italian të laboratorit të Romës.

- Nga rastet e vjetra me kryes të panjohur të veprave penale, gjatë vitit janë identifikuar 8 përputhje, duke ju falënderuar Bazës së të Dhënave të ADN-së – CODIS.
- Gjatë vitit nga Ekspertët e ADN-se janë kryer 2 teste të Jashtme të Aftësive Profesionale dhe një Ushtrim Grupor Multidisiplinar nga ENFSI.
- Ekspertët e ADN-së, po ashtu kanë marrë pjesë aktive në punën e shumë komisioneve brenda dhe jashtë AKF-së, dhe janë treguar shumë të suksesshëm, duke dhënë kontributin tyre në punën e këtyre komisioneve, për çështje të ndryshme të rëndësishme.



Foto 17. Foto e realizuar gjatë trajnimit të ekspertëve të AKF-së.

Sfidat

Divizioni i ADN-së dhe i Serologjisë është ballafaquar edhe me shumë sfida si mugesia e stafit (në gjysmën e parë të vitit, e deri pas pranimit dhe perfundimit të trajnimit të pjesës së Serologjisë nga stafi i ri), problemet teknike me sistemin LIMS dhe CODIS, dhe disa probleme tjera të cilat kanë ndikuar në punën me raste.

Si pasojë e këtyre problemeve ka pasur vonesa të ekspertizave.

Kështu që nevojitet përkrahje me e madhe, e sidomos përkrahje me e madhe teknike.

Në përgjithësi laboratori i ADN-së, me sukses e përmbyll këtë vit, për çka e falënderojmë të gjithë stafin profesional të këtij laboratorit.

4.2. Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve.

Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve është përgjegjës për analizën dhe identifikimin e narkotikeve, substancave psikotrope dhe prekursore duke përfshirë edhe substancat e reja psikoaktive. Divizioni (Laboratori) për Analiza Kimike të Narkotikëve (DAKN) e ka realizuar me sukses planin dhe objektivat e parapara gjatë periudhës kohore 01.01.2024 deri më 31.12.2024.

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë e zhvilluara, si dhe të arriturat të cilat janë realizuar me angazhimin maksimal të menaxhmentit dhe stafit të DAKN-së gjatë tërë vitit 2024, duke përfshirë numrin e rasteve të kryera, menaxhimin e kontratave, trajnimet, prezantimet në gjykata në cilësinë e ekspertit, dhe angazhimi në aktivitetet tjera të AKF-së.

Përmes këtij raporti do të paraqes aktivitetet e zhvilluara dhe të arriturat kryesore të Divizionit për Analiza Kimike të Narkotikëve gjatë periudhës kohore: 01.01.2024 deri më 31.12.2024.

Bazuar në statistikat vjetore të nxjerra nga sistemi LIM-s, Divizioni (Laboratori) për Analiza Kimike të Narkotikëve, gjatë vitit 2024, ka pranuar 1265 raste të substancave të ndryshme të dyshuara për narkotik, ndërsa janë kryer (analizuar) dhe rishikuar me sukses dhe profesionalizëm 1332 raste, me gjithsej 6285 dëshmi, raste në pritje janë 81, ndërsa në proces janë 103 raste.



Foto 18. Ekspertet e AKF-së në terren në laboratorin klandestin.

Vlen të theksohet se raste urgjente dhe rastet me prioritet, janë trajtuar si urgjente dhe janë përfunduar me sukses fal angazhimit maksimal për reduktimin në maksimum të numrit të rasteve në pritje.

- Rishikimi dhe revizionimi i Procedurave të Divizionit (Labororit) për Analiza Kimike të Narkotikëve për vitin 2024, është kryer konform rregulloreve të AKF-së dhe kritereve të standardit ISO: 17025.
- Me sukses dhe profesionalizëm është përfunduar Teste profesional (testite të zotësisë) të mbajtura në vitin 2024, që organizohen nga kompania UNODC, Internacional Collaborative EXERCISEE (ICE) 2024. Ekspertët e divizionit (labororit) për analiza kimike të narkotikëve kanë arritur rezultate të larta në testin ndërkombëtar të aftësive profesionale.

Trajnime, konferenca dhe shkëmbimet e përvojave të personelit me laboratorë tjera:

- Ekspertet e divizionit (labororit) për Analiza Kimike të Narkotikeve kanë realizuar me sukses trajnimin “Advanced training for new psychoactive drugs for Kosovo Agency on Forensic and Kosovo Police”, i cili është mbajtur në AKF.
- Ekspertet e divizionit (labororit) për analiza kimike të narkotikeve kanë realizuar vizita studimore në laboratorike ekspertë Italian nga laboratorit i Romës “Polizia Distato” në Kosovë dhe anasjelltas në kuadër të Programit të Hape për vitin 2024.
- Ekspertet e divizionit (labororit) për Analiza kimike të Narkotikeve me sukses e kanë realizuar trajnimin për Analiza kuantitative me instrumentin GC/MSMS “Krijimi i metodave dhe procedurat e analizës sasiore të drogave”, të organizuar nga Programi “Fulbright” është mbajtur në Laboratorin për Analiza kimike të Narkotikeve në AKF.
- Bashkëpunimi me laboratorin e Romës/ Itali, vizitë studimore e tre ekspertëve nga Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve në Romë.
- Ekspertet e divizionit (labororit) për Analiza Kimike të Narkotikeve me sukses e kanë realizuar trajnimin për Analizën e drogave me instrumentin HPLC-DAD dhe GC/MSMS “Krijimi i metodave për analizën e drogave”, të organizuar nga Programi “Hape” të realizuar në Laboratorin për Analiza kimike të Narkotikeve në AKF.



Foto 19. Foto nga instrumentin HPLC-DAD.

Aktivitetet e Realizuara

- Ekspertët e Divizionit për Analiza Kimike të Narkotikëve kanë marrë pjesë aktive në punën e shumë komisioneve brenda AKF-së, duke dhënë kështu kontributin e tyre në punën e këtyre komisioneve, për çështje të ndryshme të rëndësishme – Prokurim, komisione të ndryshme vlerësuese, menaxhim të kontratave etj.
- Gjatë këtij viti Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve ka arritur që të ngrite kërkesat për material hargjues të cilat janë realizuar me sukses, dhe duhet cekur se janë mjaftë e rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit të punës në laborator.
- Gjithashtu janë realizuar kërkesat për servisim dhe kalibrim të instrumenteve të DAKN, që kanë ardhur si pasojë e ndërprerjes së rrymës, dhe realizimi i tyre ka qenë mjaftë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të punës me instrumente GC/MSMS, kjo ka qenë një sfidë e madhe për DAKN.
- Pjesëmarrje në gjykatë me ftesë për pjesëmarrje në cilësinë e ekspertit.

4.3. Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit.

Divizioni për Analizë të Eksplozivëve dhe Zjarrvënjeve Divizioni për Analizë Kimike të Eksplozivëve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit është përgjegjës për analizën dhe identifikimin e Eksploziveve organik dhe inorganik të pashpërthyer apo pas shpërthimit, Zjarrvënjeve dhe analizës dhe identifikimit të mbetjeve të barotit si dhe grimcave të barotit nga kapsolla inicuese (GSR).

Gjatë vitit 2024 ne Divizionin për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënies dhe Grimcave të Barotit janë pranuar 55 raste me 242 dëshmi që janë subjekt i analizës në këtë divizion, prej të cilave shumica Grimca të Barotit por pa i përjashtuar edhe eksplozivet, ndërsa janë kryer (analizuar) dhe rishikuar me sukses dhe profesionalizëm 4 raste.

Aktivitetet me të rëndësishëm që janë kryer gjatë vitit 2024 janë:

- Riakreditimi sipas standardit ISO: 17025 i tri metodave analitike.
- Revizionimi vjetor i procedurave teknike dhe formave konform rregulloreve të AKF-së dhe kritereve të standardit ISO: 17025.
- Dëshmimi në gjykatë në cilësi të ekspertit.
- Organizimi dhe mbajtja e trajnimit bazik të brendshëm në fushën e analizës dhe identifikimit të eksploziveve organik, me ç'rast është certifikuar dhe autorizuar një ekspert për analizën dhe identifikimin e 6 eksploziveve organik me metodën Kromatografia në shtresë të hollë.
- Pjesëmarrje në takimin e 30-të vjetor të grupit punës të Armëve të zjarrit/Grimcave të barotit (GSR) e organizuar nga ENFSI (European Network of Forensic Science Institutes) si anëtarë Ekspert i Grupit punës për Grimcave të barotit (GSR), i mbajtur nga 17-20 Shtator 2024, në Vjenë/Austri.
- Në dhjetor të vitit 2024 është realizuar pjesa e parë e trajnimit për analizën dhe identifikimin e eksploziveve inorganik me Ion Chromatograf dhe FTIR i realizuar nga ekspertet e Labororit qendror të Forenzikës së Policisë Italiane, ndërsa pjesa e dytë e këtij trajnimi është planifikuar të realizohet në tremujorin e parë të vitit 2025. Ky trajnim është përkrahur nga projekti HAPE.



Foto 20. Foto nga trajnimi me ekspertet Italian ne Instrumentin Ion Chromatograph për eksplozivët inorganik.

- Takime dhe konsulta me gjitha palët që sjellin raste duke përfshirë: hetues policore, prokurorë, gjyqtarë, hetues inspektoratit, para se të dorëzohen rastet në zyrën për pranim dëshmive në AKF.

Pengesat e shfaqura gjatë implementimit të planit vjetor.

- Mungesa e stafit për Divizioni për analiza Zjarrvënjeve dhe Eksplozivëve.
- Vonesa dhe mos realizimi i trajnimit të avancuar për për analiza Zjarrvënjeve dhe Eksplozivëve me kohë nga HAPE.

5. Departamenti për Teknologji Informative Forenzike

Misioni i Departamentit të Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit është përgatitja dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit në fushën e forenzikës së teknologjisë së informacionit dhe ofrimi i shërbimeve forenzikës profesionale për institucionet e drejtësisë dhe sigurisë të Republikës së Kosovës.

Departamenti i Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit kryen detyra me përgjegjësi komplekse të nivelit përgjithësisht të diversifikuar, ku kërkohet një gjykim i konsiderueshëm për zhvillimin e qasjeve dhe teknikave të reja në të gjitha fushat funksionale për zgjidhjen e problemeve – të menduarit brenda politikave, parimeve dhe qëllimeve të përgjithshme.

Departamenti i Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit është përgjegjëse për kryerjen e ekspertizave të forenzikës në fushën e TI-së, krimeve kibernetike të varura nga teknologjia dhe krimeve kibernetike të mundësuar nga teknologjia, sistemeve të informacionit duke përfshirë sistemet kompjuterike, serverët, ruterët dhe të ngjashme.

Në kuadër të departamentit për forenzikë të teknologjisë së informacionit bëjnë pjesë divizionet: divizioni për ekspertizë të forenzikës digjitale - Nxjerrja dhe analiza e provave digjitale nga sistemet e informacionit, pajisjet e telefonisë mobile, sistemeve cloud të telefonisë mobile, sim kartelat, memori kartelat, pajisjet e navigimit, sistemeve të navigimit të veturave, bazave të të dhënave, sistemeve kompjuterike që janë aktive, pajisjet si dronët dhe pjesët periferike të tyre që përmbajnë informacione.


divizioni për ekspertizë të forenzikës multimediale - nxjerr dhe analizon provat digjitale duke përfshirë autentikimin e audio regjistrimeve, përmirësimi, transkriptimi, identifikimi i zërit, analiza e mjedisit akustik, analiza e fjalimit, analiza e metadatave, analiza spektrale, fonetika Forenzike, përpunimi digjital i sinjalit (DSP) dhe të ngjashme.

5.1. Divizioni për Ekzaminim të Kompjuterëve

Divizioni për Ekzaminim të Kompjuterëve është përgjegjës për kryerjen e ekzaminimeve të kompjuterëve, të telefonisë mobile, SIM kartelave dhe mediumeve tjera që përmbajnë të dhëna digjitale.


Gjatë këtij viti Divizioni për ekzaminimin e Kompjuterëve ka arritur që ti përmbush të gjitha objektivat për vitin 2024, përkundër numrit të madh të rasteve, provave materiale të cilat për nga volumi i hapësirës deponuese (storage) çdo vit rritet në mënyrë enorme, dhe kërkesave urgjente për ekzaminim që vijnë nga Prokuroritë dhe Gjykatat e Kosovës, e që në të shumtën e rasteve ishin urdhëresa për ekzaminim urgjente me masën e paraburgimit.

Ky divizion gjatë vitit 2024 ka kryer gjithsej 435 ekspertiza forenzike me rreth 1905 dëshmi ku 39 raste me 233 prova materiale janë trashëguar nga viti 2023.



Grafiku 3. Gjatë vitit 2024 janë pranuar gjithsej 431 raste prej të cilave 396 raste janë përfunduar dhe në vitin 2025 barten 35 prej tyre (gjendja momentale data: 13.12.2024).

Dëshmitë e rasteve ndër vite për Divizioni për ekzaminim të kompjuterëve



Grafiku 4. Dëshmitë dhe rastet ndër vite të paraqitura në mënyrë grafike (gjendja momentale data: 13.12.2024).

Angazhimet dhe zhvillimet profesionale

Gjatë vitit 2024 stafi i Divizionit ka ndjekur një numër të caktuar trajnimeve profesionale të organizuar nga ILEA, OLAF si dhe ka përfunduar me sukses testet ndërkombëtare CTS (Colaborative Testing Service).

Andaj në vazhden e këtij angazhimi në vijim kemi paraqitë një përmbledhje të shkurtër të stafit gjatë këtij viti.

1. Trajnimi në ILEA për Hetimet e Krimeve Kibernetike - Trajnim ndërkombëtar në Budapest për zyrtarët e zbatimit të ligjit, që ofron aftësi për hetimin e krimeve kibernetike, përfshirë Forenzikën e rrjetit dhe reagimin ndaj incidenteve për rritjen e sigurisë kibernetike këtë trajnim e kane ndjekur dy zyrtar të divizionit.



Foto 21. Foto nga pjesëmarrja e trajnimit për Hetimin e Krimeve Kibernetike në Akademinë ILEA-Budapest.

Trajnimi nga OLAF për “Magnet AXIOM” - Trajnim në Pragë nga OLAF që trajton metodat nxjerrjen dhe analizimit të provave digjitale përmes platformës Magnet AXIOM.




Foto 22. Foto gjatë procesit të ekzaminimit të pajisjeve digjitale!

2. Konferenca Rajonale për Sigurinë Kibernetike “CYBER ZERO” – Organizim i madh rajonal në Prishtinë, me mbi 50 folës dhe 2000 pjesëmarrës, duke trajtuar sigurinë kibernetike, dezinformimin dhe rolin e AI-së në analiza digjitale. Në të cilën kanë marr pjesë dy zyrtar si prezantues në temën “The Impact of Smartphones on School Violence” - Ndikimi i telefonave inteligjentë në dhunën në shkollë.




Foto 23. Foto nga prezantimi në konferencën CYBER ZERO!

3. Testet ndërkombëtare CTS

Në vitin 2024, dy ekspert kanë përfunduar me sukses testin ndërkombëtar CTS për Ekspertiza dhe Analizimi i Sistemeve Operative Android.

Ndërsa dy ekspert tjerë kanë përfunduar me sukses testin ndërkombëtar CTS për Ekspertiza dhe Analizim të Sistemeve Operative Windows dhe kjo ka rritur cilësinë dhe kredibilitetin e Divizionit për Ekzaminim të Kompjuterëve.




Foto 24. CTS Foto

Furnizimi me pajisje profesionale

Gjatë këtij viti është bërë furnizimi me pajisje të reja pune, duke blerë edhe një stacion punues FRED i cili ka lehtësuar punën e eksperteve dhe në të njëjtën kohë do të përshpejtoj procesin e ekspertizave.

Paraqitja në Gjykatë në cilësi të ekspertit

Stafi i Divizionit për Ekzaminim të Kompjuterëve gjatë vitit 2024 ka marre pjesë në disa seanca gjyqësore në cilësinë e ekspertit: dy ftesa për të Prezantuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, një në Gjykatën Themelore në Pejë, dy takime për konsultime profesionale me gjykatës të Gjykatës Themelore në Prishtinë në cilësinë e Ekspertit dhe një takim në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.



Foto 25. Ekspertet e DTIF-së

5.2. Divizioni për Ekzaminim të Imazheve Digjitale, Videos dhe Audio

Divizioni për ekzaminimin e Imazheve Digjitale, Videos dhe Audios është përgjegjës për kryerjen e ekzaminimeve të dëshmime, të pajisjeve elektronike, në fushën e incizimeve të videos dhe zërit. Ky divizion në përmbajtje me vetëm tre personel Ekspert të Lartë Forenzik mbulon kërkesat ekzistuese për ekspertimin e dëshmime në fushën e ekzaminimit të Imazhit Digjital, Videos dhe Audios.


Statistikat

Ky divizion gjatë vitit 2024 ka kryer gjithsej 70 ekspertiza Forenzike me rreth 148 dëshmi. Kjo shifër tregon se ky Divizion mban një numër mesatare të numrit të rasteve ndër vite por me tendence rritjeje për arsye sepse teknologjia po zhvillohet me hapa shumë të shpejtë dhe ngase në jetën e përditshme video/audio regjistrimet janë bërë pjesë e pandashme e jetës.

Gjithashtu teknologjia në zhvillim dhe e qasëshme pothuaj në çdo pore të jetës po bëhet në këtë mënyrë pjesë ose dëshmitare e ngjarjeve mbi të cilat pastaj edhe ndërtohet procesi hetues për rastet Penale ose Juridike dhe në këtë mënyrë mundësojnë edhe zbardhjen e drejtësisë aty ku është mundshme.


Gjatë këtij viti kanë dominuar rastet me dëshmi të kamerave të sigurisë me pajisje të DVR-ve me mbi 64% të totalit të rasteve, kurse rastet me materiale të ndryshme të video/audio regjistrimeve ku kërkohet pastrimi i audio regjistrimeve, qartësimi i video incizimeve arrijnë në 23% të rasteve. Rastet tjera, 3% prej tyre janë raste të ndryshme në mediume të ndryshme si kamera sportive GoPro, SD kartela apo edhe HDD me video dhe audio regjistrime.

Rastet e Ekzaminuara ndër vite për Divizioni për Ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Zërit.



Grafiku 5. Gjatë vitit 2024 janë pranuar gjithsej 71 raste prej të cilave 66 raste janë përfunduar dhe ne vitin 2025 barten vetëm 5 prej tyre (gjendja momentale data: 11.12.2024).

Dëshmitë e ekzaminuara ndër vite për Divizionin për Ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Zërit.



Grafiku 6. Dëshmitë dhe rastet ndër vite të paraqitura në mënyrë grafike (gjendja momentale data: 11.12.2024).

Procesi i ekzaminimit Forenzik

Procesi i ekzaminimit Forenzik të imazhit digjital, videos dhe audios është një qasje sistematike dhe shkencore që synon të analizojë, rivendosë, përpunojë dhe interpretojë të dhënat multimediale me qëllim përdorimin e tyre në hetime ligjore ose administrative. Ky proces përfshin teknika dhe mjete të avancuara për të ruajtur integritetin e provave, për të identifikuar origjinën e tyre dhe për të nxjerrë informacione të vlefshme pa komprometuar autenticitetin e materialit.

Hapat kryesorë të procesit:

- **Ruajtja dhe Përgatitja e Provave:** Ruajtja e sigurt dhe dokumentimi i materialeve digjitale për të siguruar që nuk janë modifikuar gjatë procesit të analizës.
- **Verifikimi i Autenticitetit:** Verifikimi i origjinalitetit të imazheve, videove dhe audios për të përcaktuar nëse janë manipuluar ose falsifikuar.
- **Rivendosja dhe Përpunimi:** Riparimi i skedarëve të dëmtuar, pastrimi i zhurmave, përmirësimi i cilësisë së imazhit ose audios për nxjerrjen e detajeve më të qarta.
- **Analiza Teknike:** Analiza e metadatave për të identifikuar detajet teknike (si data, ora, pajisja e përdorur) dhe ekzaminimi i përmbajtjes për të zbuluar modele të mundshme të manipulimit ose për të nxjerrë informacione specifike.
- **Interpretimi i Rezultateve:** Përkthimi i analizave teknike në gjetje që janë të kuptueshme dhe të rëndësishme për hetimin.
- **Raportimi dhe Dëshmia:** Hartimi i raporteve përfundimtare dhe prezantimi i tyre në gjykatë ose institucione të tjera relevante, duke respektuar standardet ligjore dhe etike.

Qëllimi:

Të sigurojë të dhëna të besueshme dhe të sakta që mund të përdoren për të provuar ose kundërshtuar pretendime në çështje ligjore, për të identifikuar autorët e veprimeve të paligjshme, ose për të hedhur dritë mbi rrethanat e një ngjarjeje. Ky proces kërkon profesionalizëm, njohuri të thella teknologjike dhe përkushtim për të siguruar që asnjë detaj nuk lihet pa u ekzaminuar.

Angazhimet profesionale

Stafi i angazhuar në ekzaminimin Forenzik të imazhit digjital, videos dhe audios duhet të jetë i trajnuar vazhdimisht, duke ndjekur zhvillimet më të fundit teknologjike dhe standardet ndërkombëtare. Kjo siguron që ata të jenë të aftë të përdorin teknologjitë më të avancuara, të zbatojnë praktikatat më të mira dhe të përballojnë sfidat e reja që lidhen me analizimin dhe interpretimin e të dhënave multimediale në mënyrë të besueshme dhe profesionale.

Andaj në vazhden e këtij angazhimi në vijim kemi paraqitë një përmbledhje të shkurtër të stafit gjatë këtij viti.

- **Trajnimi në ILEA për Ndërhyrje në Kompjuterë dhe Rrjete** - Trajnim ndërkombëtar në Budapest për zyrtarët e zbatimit të ligjit, që ofron aftësi për hetimin e krimeve kibernetike, përfshirë Forenzikën e rrjetit dhe reagimin ndaj incidenteve për rritjen e sigurisë kibernetike.
- **Punëtoria për Draft Rregulloren e MPB nr. xx/2024** - Punëtori për hartimin dhe finalizimin e rregullores që përcakton strukturën organizative dhe vendet e punës në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.
- **Grupi Punues për Menaxhimin e Përformancës në AKF** - Takim tre-ditor në Vërmicë për të zhvilluar sistemin e menaxhimit të përformancës në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë për vitin 2025.
- **Trajnimi OLAF për “Live Data Forensics”** - Trajnim në Pragë nga OLAF që trajton metodat e avancuara për analizimin e të dhënave të drejtpërdrejta dhe mbledhjen e provave digjitale për hetime të specializuara.
- **Rishikimi i Strategjisë Zhvillimore të AKF-së (2022-2026)** - Sesioni i rishikimit strategjik të zhvillimit të AKF-së, që do të mbahet më 6 Dhjetor 2024 në Prishtinë, për të përditësuar qëllimet dhe prioritetet afatmesme.

- **Konferenca Rajonale për Sigurinë Kibernetike “CYBER ZERO”** – Organizim i madh rajonal në Prishtinë, me mbi 50 folës dhe 2000 pjesëmarrës, duke trajtuar sigurinë kibernetike, dezinformimin dhe rolin e AI-së në analiza digjitale. Në të cilën kemi marre pjesë si prezantues në temën “The Impact of Smartphones on School Violence” - Ndikimi i telefonave inteligjentë në dhunën në shkollë.

Takime online:

- **VOCALISE user group meeting** – në temën: ‘Exploring speaker similarity based selection of relevant populations for forensic automatic speaker recognition’ - Ky hulumtim heton strategji të ndryshme për përzgjedhjen e popullatave përkatëse dhe ndikimin e tyre në njohjen automatike Forenzike të folësve në një kornizë të raportit të gjasave. Përveç përzgjedhjes së rastësishme dhe të bazuar në të dhëna demografike, ai eksploron ngjashmërinë perceptuese të zërit si një kriter potencial. Duke përdorur një bazë të dhënash të kontrolluar për gjininë, gjuhën dhe kushtet e regjistrimit, u përdor një qasje automatike e bazuar në veçoritë fonetike për të zgjedhur folësit më të ngjashëm dhe më pak perceptualisht të ngjashëm me regjistrimet e folësve të pyetur në rastet testuese.

Programet Forenzike:

Stafi është i specializuar në përdorimin e programeve Forenzike specifike dhe janë profesionistë të trajnuar që zotërojnë njohuri të thella dhe aftësi praktike për të aplikuar standardet operative të aprovuara (SOP) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ata sigurojnë që çdo analizë dhe përpunim i të dhënave kryhet në përputhje me metodologjitë e akredituara nga laboratorët Forenzike ndërkombëtarë, duke nxjerrë rezultate të sakta, të besueshme dhe të vlefshme për hetimet ligjore dhe shkencore. Disa nga programet në përdorim janë si më poshtë:

- **Amped Image Authenticate** - Një program për verifikimin e autenticitetit dhe integritetit të imazheve digjitale duke analizuar metadata, artefaktet e kompresimit dhe manipulimet e mundshme.




Foto 26. Amped Image Authenticate.

- Amped Video Authenticate - Një mjet Forenzik për të analizuar videot dhe për të identifikuar shenja manipulimi ose ndërhyrjeje, duke përdorur teknika të avancuara.
- Amped FIVE - Një program gjithëpërfshirës për përmirësimin, analizimin dhe prezantimin e imazheve dhe videove digjitale për qëllime hetimore.




Foto 27. Amped Five.

- Amped Replay - Një mjet intuitiv për hetuesit, që mundëson rishikimin, redaktimin dhe anotimin e provave video për përdorim në hetime dhe në gjykatë.

- DVR Examiner - Një program Forenzik që lehtëson rikuperimin dhe analizimin e videove direkt nga sistemet DVR, edhe kur ato janë të dëmtuara ose të paarritshme.




Foto 28. DVR Examiner.

- Oxford Vocalize - Një mjet Forenzik për përmirësimin e qartësisë së zërit, ndarjen e folësve dhe transkriptimin e regjistrimeve të vështira.




Foto 29. Oxford Vocalize.

- RX 5 iZotope - Një program i fuqishëm për riparimin dhe përmirësimin e audios, që largon zhurmat dhe përmirëson cilësinë për aplikime Forenzike.



Foto 30. Izotope RX.

- Tableau Forensic Imager - Një zgjidhje harduerike dhe softuerike për krijimin e imazheve të pajisjeve të ruajtjes, duke garantuar marrje të shpejtë, të besueshme dhe të sigurt të të dhënave.
- Atola Insight Forensic - Një mjet për rikuperimin e të dhënave dhe krijimin e imazheve Forenzike nga pajisjet e dëmtuara ose komplekse, me diagnostikim automatik dhe raportim të detajuar.
- UFED4PC - Një platformë softuerike Forenzike për nxjerrjen, dekodimin dhe analizimin e të dhënave nga pajisjet mobile, duke ofruar njohuri të vlefshme për hetimet.

Sfidat e Ekspertit Forenzik në Fushën e Audios dhe Videos

Eksperti Forenzik që operon në fushën e audios dhe videos ballafaqohet me një sërë sfidash komplekse dhe teknike, të cilat kërkojnë aftësi të avancuara, burime të mjaftueshme dhe koordinim të mirë me ekipet hetimore dhe gjyqësore. Këto sfida ndahen në disa kategori kryesore:

1. Trajnimet dhe Përditësimet Teknike

Fusha e audios dhe videos është në zhvillim të vazhdueshëm, me teknologji dhe teknika të reja që prezantohen rregullisht në konferenca ndërkombëtare dhe platforma shkencore. Eksperti duhet:

- Të marrë pjesë në trajnimet më të fundit, veçanërisht në teknologjitë e avancuara për autentikimin e audios dhe videos.

- Të përshtatet me teknikat më të reja për të përmirësuar procesin e analizës dhe sigurimit të të dhënave të sakta.
- Të jetë në kontakt të vazhdueshëm me zhvillimet globale për të ruajtur standardet më të larta profesionale.

2. Kapacitetet e Kufizuara të Hapësirës së Ruajtjes

Materialet Forenzike, sidomos ato që përfshijnë regjistrime të videos dhe audios, kanë kërkesa të larta për ruajtjen e të dhënave:

- HDD të DVR-ve shpesh kanë kapacitete të mëdha që variojnë nga disa terabajt deri në dhjetëra terabajt për një rast të vetëm. Kjo krijon sfida logjistike për ruajtjen dhe menaxhimin e këtyre të dhënave.
- Në raste të veçanta, raportet përfshijnë përmbajtje mbi 25 TB, që është pothuajse e pamundur të përshtatet në medime të zakonshme për rishikim ose dorëzim në proceset gjyqësore.
- Kërkohet optimizmi i burimeve teknike, si dhe implementimi i teknologjive të përparuara për kompresimin dhe menaxhimin e materialeve pa humbur cilësinë e nevojshme.

3. Koordinimi me Hetuesit dhe Mungesa e Informacioneve Kyçe.

Një nga sfidat më të zakonshme është mungesa e informacionit të plotë nga hetuesit, e cila ndikon në:

- Përcaktimin e kohës së ngjarjes në DVR. Shpesh regjistrimet nuk përputhen me datën dhe kohën reale për shkak të konfigurimeve të pasakta në pajisje ose mungesës së sinkronizimit të orës së sistemit.
- Kërkesat për dorëzimin e të gjithë përmbajtjes, pavarësisht se pjesa më e madhe mund të jetë e parëndësishme për çështjen hetimore, çon në harxhimin e panevojshëm të kohës dhe burimeve.
- Shpenzimin e orëve të tëra duke dëgjuar materialin audio kur nuk është specifikuar koha e interesit, duke vonuar procesin e analizës dhe duke rritur barrën mbi ekspertët.

4. Kompleksiteti i Analizës së Audios dhe Videos

Ekspertët duhet të përballen me sfida teknike dhe metodologjike gjatë procedimit dhe autentikimit të materialeve:

- Në autentikimin e audios, përcaktimi i origjinalitetit të materialit është një proces i ndërlikuar që kërkon njohuri të avancuara mbi sinjalet digjitale, analizën spektrale dhe zbulimin e ndërhyrjeve të mundshme. Pastaj popullimi i programit të Audios me incizime reale për secilin rajon apo dialekt për të mundësua gjetjen e përafërt të probabilitetit të Folësit të mundshëm të involvuar në rast, në mungesë të incizimeve tilla (mbi 30 incizime të secilit rajon, gjini, moshës së përafërt, dhe pajisjes-modelit të njëjtë të përfshirë në rast) është e pamundur të nxirret probabiliteti i Folësit të involvuar në rast.
- Në analizën e videos, zbulimi i manipuluar ose i ndërprerjeve kërkon mjete të avancuara që mund të mos jenë gjithmonë të disponueshme. Përpunimi dhe restaurimi i materialeve me cilësi të ulët, si audio me zhurmë të lartë ose video me rezolucion të dobët, janë procese që kërkojnë kohë dhe resurse teknologjike të konsiderueshme.

5. Menaxhimi i Shpejtësisë dhe Efikasitetit

Presionet për përfundimin e analizave brenda një afati të caktuar shpesh bien ndesh me kompleksitetin e rasteve. Eksperti duhet të gjejë balancën midis saktësisë dhe shpejtësisë për të siguruar rezultate të vlefshme për proceset hetimore dhe gjyqësore.

6. Sigurimi dhe Rishikimi i Materialeve

Shpesh herë, kërkesa për të ofruar materiale për rishikim nga palët e tjera hetimore ose ligjore është sfiduese. Pajisjet dhe teknologjitë standarde të shpërndarjes së të dhënave nuk mund të përballojnë volumet e mëdha të materialeve.

Zgjidhje do të ishte krijimi i serverëve të dedikuar për rishikim ose përdorimi i sistemeve të avancuara të menaxhimit të të dhënave.

Sfidat në fushën e audios dhe videos kërkojnë jo vetëm aftësi teknike të larta, por edhe burime të mjaftueshme teknologjike dhe një koordinim të mirë ndërmjet ekspertëve dhe palëve të tjera të përfshira në proces. Trajnimi i vazhdueshëm, përdorimi i teknologjive më të fundit dhe një menaxhim efikas i kohës dhe burimeve janë faktorë thelbësorë për tejkalimin e këtyre sfidave.

6. Divizioni për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Divizioni për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP) edhe gjatë vitit 2024, si njësi e veçantë në kuadër të organizimit të brendshëm të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë edhe përkundër sfidave që ka pasur në mungesës të personelit të mjaftueshëm, ka realizuar të gjitha detyrat, përgjegjësit dhe punët që janë përcaktuar nga legjislacioni dhe drejtuesit e AKF-së.

Realizimi i detyrave dhe përgjegjëseve që ka ky Divizion janë të rëndësishme për të mos thënë se punët që i kryen ky Divizion nga zyrtarët e saj mundësojnë funksionimin e rregullt të veprimtarisë dhe aktiviteteve të përditshme të AKF-së, e në mënyrë të përmbledhur këto punë kanë të bëjnë me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e informatave për burimet njerëzore (çështjet e personelit, pagave, mëditjet, pushimet, etj.) këshillimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të legjislacionit për burime njerëzore, hartimin e shkresave dhe akteve tjera administrative, pastaj hartimin, menaxhimin koordinimin, përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të agjencisë (vlerësimin e kërkesave financiare, pagesat ndaj operatorëve, inicimin e procedurave për prokurim etj.).




Foto 31. Zyrtarja e Burimeve Njerëzore gjatë punës se zakonshme.

7. Përkufizimi i termave dhe lista e shkurtesave

AAFS	American Academy of Forensic Science
ADN	Acidi dezoksiribonukleik
ABIS	Sistemi për Identifikim Automatik të Gjurmëve të gishtërinjve
AKF	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
AKREDITIM	Nënkupton procedurën e njohjes zyrtare, të kompetencës së një organi për vlerësimin e konformitetit në përputhje me standardet dhe me rregullat teknike për të kryer detyra, si: testim, kalibrim, certifikim ose inspektim
CODIS	Combined DNA IndexSystem – Databazë për AND
CTS	Shërbimet Testuese të Zotësisë
DËSHMI	Dokumenti, prova që dëshmon ndonjë fakt të caktuar
IML	Instituti për Mjekësi Ligjore
DT	Departamenti i Traseologjisë
DTI	Departamenti për Teknologji Informative
EKSPERTIZË	Hulumtimi, hetimi, gjurmimi, vlerësimi apo studimi i provuar, përfshirë edhe raportet nga këto aktivitete, konstatimet dhe rezultatet që kërkojnë njohuri specifike dhe të cilat kryhen nga ekspertë për të vërtetuar dhe dhënë mendimin mbi faktet e caktuara
ENCASE	Program digjital forenzik për ekzaminime kibernetike
ENFSI	Rrjeti Evropian i Instituteve Shkencore Forenzikë

EULEX	Mision Evropian në Kosovë për zbatim të ligjit
FTI	Forenzika e Teknologjisë Informative
HULUMTIM	Vepër e shkruar, në të cilën është shqyrtuar një çështje apo paraqiten të dhënat që janë mbledhur nga kërkimet për një çështje, gjurmime, gjetje ose arritje shkencore
IAFI	International Association of Forensic Institutes
IBISS	Sistemi i Integruar për Identifikime Balistike
ICITAP	Program për ndihmë dhe trajnim ndërkombëtar për hetimet kriminale
ISO STANDARDI	Standardi ndërkombëtar i cilësisë
ISO	Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit
KGJK	Këshilli gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli prokurorial i Kosovës
LABORATOR	Nënkupton divizionin e caktuar në kuadër të AKF-së që merret me veprimtari shkencore të ekspertimit
LIMS	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Laborator
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
METODA	Nënkupton veprimet shkencore që aplikohen nga njësitet e caktuara në kuadër të AKF-së gjatë kryerjes së ekspertimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme

OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PROVË	Vërtetimi i të dhënave që duam të njohim a ta studiojmë më thellë: eksperiment që bëhet për të marrë të dhëna për diçka, për të kontrolluar saktësinë e diçka-je, veprim paraprak që bëhet për të kontrolluar apo vërtetuar saktësinë e një lloji, një gjëje, a mase të diçka-je, duke u mbështetur në fakte a dëshmi. Prova është e dhënë që vërteton ose mohon diçka;
STANDARDI	Nënkupton rregullat e aplikuara nga ISO –ja për akreditimin e laboratorëve testues dhe kalibrues
SEM	Mikroskopi elektronik skanues
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHKENCA E FORENZIKËS	Aplikimi i shkencave (kimi, biologji, fizikë, matematikë, inxhinieri, makineri, kriminalistikë, etj.) për gjetjen, identifikimin, individualizimin, analizimin dhe vlerësimin e dëshmive fizike (provave materiale) për çështje ligjore penale dhe civile
UP	Universiteti i Prishtinës



DNA
STRAND

DIGITAL
FORENSICS
WORKSTATION

BALLISTIC
EVIDENCE



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme

Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/ Ministry of Internal Affairs



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË

Kosovska Agencija za Forenziku | Kosovo Agency on Forensic



Zona Industriale

Rruga 12 Qershori nr. 101

10000 Prishtinë – Kosovë



+381 (0) 38 / 200 76302



agjencia.forenzikes@rks-gov.net